

VENDIM
Nr. 951, datë 26.12.2012

**PËR LEJIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE PËR
VAZHDIMIN/KRYERJEN/PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT, ME
OBJEKT “FURNIZIMI ME UJË I PLAZHEVE DURRËS-KAVAJË NGA PUSHPIMET E
ÇERMËS, LOTI III (LINJAT E UJËSJELLËSIT NGA PIK 235 (DEGËZIMI NË KAVAJË) DERI
NË DEPON E RE 4000 M³, NË ARAPAJ, DEPO ARAPAJ 4000 M³)”, SI AUTORITET
KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjiellës-Kanalizimeve, si autoritet kontraktor, për vazhdimin/kryerjen/përfundimin e procedurave të prokurimit, me objekt “Furnizimi me ujë i plazheve Durrës-Kavajë nga pusshpimet e Çermës, loti III (linjat e ujësjiellësit nga PIK 235 (degëzimi në Kavajë) deri në depon e re 4000 m³, në Arapaj, depo Arapaj 4000 m³)”.

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës-Kanalizimeve dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha